



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 193

Tiranë – E martë, 8 janar 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 119/1 /2018, datë 3.12.2018	Për mosmiratimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e nivele të tarifës doganore”, të ndryshuar..... 15179
Dekret i Presidentit nr. 11017, datë 21.12.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 15179
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 38, datë 26.12.2018	Për datat dhe organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2019.... 15179
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 27, datë 20.4.2018	Për miratimin e “Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”..... 15180
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 28, datë 23.4.2018	Për një shtesë në “Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”..... 15181
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 244, datë 22.12.2018	Për delegim kompetence..... 15182
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 76, datë 6.11.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë..... 15182

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 78, datë 26.11.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Malësi e Madhe”, i ndryshuar.....	15183
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 79, datë 26.11. 2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Roskovec.....	15185
	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.....	15186
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Altin Daja.....	15186
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzo Kuçuku..	15187
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Jeto Mukaj.....	15187



VENDIM
Nr. 119/1 /2018

PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008 “PËR
MIRATIMIN E NIVELE TË TARIFËS
DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 55, të Rregullores së Kuvendit

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2018

DEKRET
Nr. 11017, datë 21.12.2018
PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar. Bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mandush Gani Çela (Kusari)
2. Giuseppe Gaetano Salvatore Schiliro
3. Shukrane Ramadan Meshi (Latifi)
4. Agnesa Muharrem Reshiti (Haziraj)
5. Luljete Sherif Nuhiallari (Zeneli)
6. Ajne Tahir Çelaj (Dukaj)
7. Laura Fatmir Gjakova (Krypa)
8. Igballe Ismail Mehmeti (Novosella)
9. Xhemile Malja Pepa (Sadiku)

10. Bedri Elmi Amrush
11. Tatyana Valeriyana Pak
12. Xhenet Shyqri Syka Kelmendi (Syka)
13. Sümeysra Kadir Uyrca (Çorumlu)
14. Zana Tahir Lluhani (Lila)
15. Xheladin Bekë Zeka
16. Erhan Mehmed Bula
17. Fatmir Xhafer Pnishi
18. Luljeta Ramiz Osmonaj (Bajramaj)
19. Selver Ali Çukovci
20. Nicoleta-Vasilica Nicolae Shini (Nucă)
21. Rozafa Fadil Kelmendi
22. Manuella Tomë (Tom) Berisha
23. Fatime Rustem Jaupaj (Qallapeku)
24. Violeta Zymer Sallahu/Sallaku (Dervishaj)
25. Halim Osman Yilmaz
26. Genc Hasan Ahmetaj
27. Oxana (Oksana) Sergej Uteva (Utjeva)
28. Nasry Ibrahim Awwad
29. Nazim Isuf Kryeziu
30. Agron Halil Buçinca
31. Loris Giorgio Castriota Skanderbeg

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 38, datë 26.12.2018

PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE 2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2019, të jenë:
 - a) Gjuhë e huaj: 7 qershor 2019;
 - b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 12 qershor 2019;
 - c) Matematikë: 17 qershor 2019;
 - d) Provimi me zgjedhje: 24 qershor 2019.



2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, miratuar me urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, të përcaktojnë testin për secilin provim të Maturës Shtetërore.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019:

4.1 Fillojnë në orën 10:00.

4.2 Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.

4.3 Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.

4.4 Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.

4.5 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, rijapin provimet në sesionin e dytë.

5. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018–2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

5.1 Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

5.2 Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, “Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë”.

5.3 Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

5.4 Testi i provimit “Gjuhë frënge” (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

5.5 Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit pakëtohen për çdo qendër më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.

5.6 Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2019 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 27, datë 20.4.2018

**PËR MIRATIMIN E “KODI ETIK I
KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË
LARTË TË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT”**

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe përfitimet e institucioneve supreme të auditimit - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,



VENDOSA:

Miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si përmbledhje e tri dokumenteve kryesore:

Kodit të Etikës së KLSH-së;

Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë; dhe

Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t, në veçanti, ISSAI 30 “Kodi i Etikës” i INTOSAI-t.

Neni 1

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si trupa drejtuese e institucionit që duhet të përcjellë vlerat më të larta dhe të realizojë misionin e kësaj strukture kushtetuese, miratohet dhe hyn në veprim me synim forcimin e mëtejshëm të integritetit dhe transparencës së institucionit suprem të auditimit, i cili drejton nëpërmjet shembullit, mbi bazën e parimit ndërkombëtar “tone at the top” (përgjegjësia në radhë të parë të drejtuesit). Ai mbështetet në tri dokumente kryesore:

i. në Kodin e Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 56, datë 30.4.2015;

ii. në Kodin e Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 5.4.2018; dhe

iii. në Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t.

Neni 2

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së është plotësim integral i Kodit Etik të institucionit, kreu “Dispozita të Përgjithshme”, neni 4, pika 4.3.

Neni 3

Kryetari i KLSH-së, sekretari/drejtorët e Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve/drejtorive dhe Kryeaudituesit njohin dhe zbatojnë pa asnjë kusht, me rigorozitet dhe përpikëri Kodin e Sjelljes së Deputetëve, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 5.4.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, punuar me ekspertë të OSBE-së, si një ndër standardet më të larta në vend dhe

etalon të sjelljes etike të një nëpunësi të Shtetit, zbatimi i të cilit i mundëson institucionit dhe ekipit drejtues të tij një imunitet të fortë ndaj konfliktit të interesit dhe sjelljeve në dëm të interesave të qytetarit.

Neni 4

Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të cenojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t’u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke jua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së lexohet dhe zbatohet integralisht në të tria dokumentet e cituara në nenin 1 dhe në këtë vendim.

KRYETAR
Bujar Leskaj

VENDIM

Nr. 28, datë 23.4.2018

**PËR NJË SHITESË NË “KODI ETIK I
KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË
LARTË TË KONTROLLIT TË LARTË TË
SHTETIT”**

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe përfitimet e institucioneve supreme



të auditimit - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA:

Në Kodin Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, në nenin 4 shtohet një paragraf me përmbajtjen:

Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për një periudhë prej 4-mujsh nga data e përfundimit të mandatit, Kryetari që dorëzon detyrën nuk merret me aktivitet aktiv politik.

KRYETARI
Bujar Leskaj

VENDIM Nr. 244, datë 22.12.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Bazuar në:

- Nenin 162/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se “Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit “qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje”;

- Nenin 25, germa “ë”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi kompetencën e Kryetarit “Për të përcaktuar strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Nenin 23, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, që përcakton se “Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron, kur: a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë”;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, udhëzuesit e aplikueshëm dhe praktikat më të mira bashkëkohore që i kontribuojnë mbrojtjes së paanshmërisë, objektivitetit, neutralitetit politik dhe besueshmërisë së institucionit suprem të auditimit (ISSAI 30);

- Ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.4.2018, “Për miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së”;

- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 238, datë 21.12.2018, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 4, datë 27.1.2017, “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar”,

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Lindita Lati (Milo) nga data e botimit në fletoren zyrtare deri në paraqitjen në detyrë të Kryetarit të ri të KLSH-së.

3. Vendimi do përcillet në fletoren zyrtare, pasi Kryetari i KLSH-së të kontaktojë dhe të marrë mirëkuptimin e Presidentin të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare të opozitës dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

4. Kryetari i KLSH-së i kërkon Kryetarit të Kuvendit që Konferenca e Kryetarëve të njihet me këtë vendim.

5. Vendimi përcillet në Fletoren Zyrtare në ditët e para të janarit dhe hyn në fuqi pas botimit në të.

KRYETARI
Bujar Leskaj

VENDIM Nr. 76, datë 6.11.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME HIMARË

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për



shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 6.11.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime Himarë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, konstatoi se:

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Himarë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 2, datë 19.1.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Himarë”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Himarë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 80 prot., datë 5.7.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për tarifën mujore, shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Himarë kishte mangësi në dokumentin “Mendimi i pronarit (Njësia e Qeverisjes Vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori”.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë, me shkresën nr. 350/1 prot., datë 20.7.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Himarë, me shkresën nr. 96 prot., datë 11.10.2018 ka dërguar dokumentin e munguar “Mendimi i pronarit (Njësia e

Qeverisjes Vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Himarë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Himarë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Himarë dhe Bashkinë Himarë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 78, datë 26.11.2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 51, DATË 2.12.2016, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS MALËSI E MADHE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 26.11.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria



Juridike mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Malësi e Madhe sh.a., për ndryshimit të licencës për shkak të shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura,

VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe” (UK Malësi e Madhe), me shkresën nr. 1462 prot., datë 21.9.2018, me lëndë “Dërgim dokumentacioni” dhe shkresën nr. 1555, datë 25.10.2018, “Dërgim dokumentacioni” ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për shkak të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për rinovim licence për efekt të shtimit të kategorisë për largimin e ujërave të ndotura UK Malësi e Madhe në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Ujësjiellës Malësi e Madhe ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë me dokumentacionin si më poshtë:

- Me vendim të Këshillit Bashkiak Malësia e Madhe nr. 149, datë 25.7.2018 është vendosur kalimi i sistemit të kanalizimeve pranë shoqërisë Ujësjiellës Malësi e Madhe sh.a.;

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe nr. 6285 prot., datë 28.9.2018 është miratuar zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me marrjen e aseteve për ofrimin e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura;

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe nr. 6791 prot., datë 25.10.2018, “Mbi ndryshimin e emërimit të shoqërisë Ujësjiellës Malësi e Madhe”.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruar, rezultoi:

- a) ERRU-ja ka licencuar shoqërinë Ujësjiellës Malësi e Madhe me vendim nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Malësi e Madhe”, i ndryshuar me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik;

- b) Shoqëria UK Malësi e Madhe ka marrë në administrim sistemin e kanalizimeve nga Bashkia Malësi e Madhe dhe do të ofrojë shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për 3500 banorë në njësinë administrative Koplik;

- c) Shoqëria ka ndryshuar emrin nga shoqëria “Ujësjiellës Malësi e Madhe” sh.a. në shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe” sh.a.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për shtimin e kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Ujësjiellës Malësi e Madhe sh.a., të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë të garantojë që të licencuarit të veprojnë në përputhje me kushtet e licencës së tyre dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

- c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

- d) Kërkesave të VKM-së nr. 63, veçanërisht në lidhje me organizimin e njësive të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si shoqëri aksionare sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionimit në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

6. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së Ujësjiellës Malësi e Madhe rekomandon:

- Shoqëria UK Malësi e Madhe duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë konsumatorët të marrin shërbimin e largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve;



- Shoqëria UK Malësi e Madhe duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit ujërave të ndotura.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Malësi e Madhe është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

I. Titulli i vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe”, i ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“Për licencimin e Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.”

II. Kudo në vendimin nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe”, i ndryshuar, togfjalëshi “sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe” ndryshohet si më poshtë:

“Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.”.

III. Në pikën 2 të vendimit shtohet kategoria si më poshtë:

“Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura”.

IV. Pika 3 e vendimit ndryshon si më poshtë:

“Zona e shërbimit të këtij operatori sipas kategorive është si më poshtë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik - Bashkia Malësi e Madhe;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura – Njësia Administrative Koplik”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 79, datë 26.11.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ROSKOVEC

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 26.11.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime Roskovec sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Roskovec është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 53, datë 23.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Roskovec” pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Roskovec ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 165 prot., datë 29.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë



të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Roskovec kishte mangësi:

- “Seanca Dëgjimore me Publikun”, nuk ishte zhvilluar konform udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore ku të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ERRU-së.

- “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë, me shkresën nr. 336/1 prot., datë 23.7.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Roskovec, me shkresë nr. 226 prot., datë 21.9.2018 ka njoftuar ERRU-në për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me Publikun dhe me shkresë nr. 237 prot., datë 10.10.2018 ka dërguar procesverbalin e zhvillimit të saj.

Shoqëria UK Roskovec ka dërguar, me shkresën nr. 253 prot., datë 5.11.2018 dokumentin e munguar “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave”, protokolluar në ERRU, me shkresë nr. 459 prot., datë 13.11.2018.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Roskovec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Roskovec për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e Rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

Deklasifikohen pjesërisht informacionet e mëposhtme:

1. Shkresa me lëndë “kthim përgjigje”, ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme me nr. prot. 2431/10, datë 1.10.2018 klasifikuar “Sekret shtetëror”, protokolluar me ZIK të KPK-së me nr. prot. 1313, datë 1.10.2018. Ky dokumentacion përmban 7 (shtatë) fashikuj, akte të procedimit penal me nr. 202, regjistruar në datën 20.7.2007, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ky informacion u deklasifikua pjesërisht me vendimin nr. 1, datë 26.12.2018, të KDZH-së të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Publikimi i Bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare, në faqen zyrtare të internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe në mënyra të tjera, ndërsa një kopje t’i dërgohet zyrtarisht DSIK-së.

KRYETARI
Genta Tafa (Bungo)

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 932(2220), datë 12.11.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Altin Ahmet Lide Daja (i thirrur ndryshe si Artur), i datëlindjes 21.5.1972, si dhe caktimin e shtetases Xhiblerta Ahmet Lide Mema si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-5825) 1767, datë 14.11.2018, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzo Veip Kuçuku, i datëlindjes 5.4.1926, si dhe caktimin e datës së vdekjes, më 31.12.2000.

KËRKESË

Shtetasi Ali Mukaj, i biri i Veip dhe Zylfi, kërkon pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë shpalljen të vdekur të shtetasit Jeto Mukaj.

KËRKUES**Ali Mukaj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë